

UDHËZIM
(Shtese)
Nr.2 ,date 18.1.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.7 DATË 16.6.2003 “PËR AKCIZAT”

Ne zbatim te nenit 55 te Ligjit nr. 8976 “Per Akcizat”, Ministri i Financave, nxjerr kete

UDHËZON:

Ne Udhëzimin nr.7, date 16.06.2003 ne zbatim te ligjit nr. 8976, date 12.12.2002 “Per Akcizat”, behen ndryshimet si me poshte:

1. Ne pjesen IX – PROCESET E PERJASHTUARA DHE TE MIRATUARA, ne piken 29 Proceset e miratuara nen regjimin e rimbursimit te akcizes, ne paragrafin 29.1 Proceset e miratuara te percaktuara, ne Nenin 19(2)(a), shtohet pika “e” me kete permbajtje :

Prodhimi i mallrave jo te tatueshem me akcize nga lende te para per te cilat eshte paguar akcize.

2. Ne pjesen IV – LEVIZJA E MALLRAVE TE AKCIZES, ne piken 15 Marrja ne dorezim e ngarkesave te importuara te mallrave te akcizes nen regjimin e pezullimit tatimor, shtohet paragrafi 15.18 me kete permbajtje:

15.18. Drejtoria e Pergjithshme e Doganave percakton menytrat e administrimit te akcizes se pijeve alkoolike mbi bazen e perqindjes se alkoolit sipas ndarjes ne pjesen me kod 22 08 te tabelës se mallrave te tatueshem me akcize ne Ligjin 8976 date 12.12.2002 “Per Akcizat”.

3. Ne pjesen XII – PULLAT E AKCIZES, ne piken 44 Kerkesa per pulla akcize nga nje tatimpagues i autorizuar akcize, ne paragrafin 44.1 shtohen nenndarjet si me poshte:

44.1.1 Kur nje person kerkon nje sasi pullash akcize qe nuk e kalon shumen prej 1000 pulla dhe nuk eshte tatimpagues i autorizuar akcize ose perfaqesues fiskal, ai person mund te beje kerkese drejtperdrejte ne Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve per te blere pulla.

44.1.2 Kur merret nje kerkese per blerjen e nje sasie te vogel te pullave te akcizes, inspektori i pullave te akcizes i paraqet aplikantit nje formular porosie te pullave, sipas modelit qe I bashkangjitet Udhëzimit nr.7 datë 16.6.2003 “Për Akcizat”. Aplikanti duhet te plotesoje formularin me te dhenat e kerkuara dhe duhet te paguaje shumen e tatimit ne numrin e llogarise bankare te cilen ia jep inspektori i kontrollit te pullave te akcizes.

44.1.3 Aplikanti merr nje mandat-arketimi nga banka dhe ia dorezon se bashku me formularin e porosise inspektorit te kontrollit te pullave i cili pastaj do t’i leshoje sasine e kerkuar te pullave. Inspektori mban kopjen e pare dhe te trete te formularit dhe te mandat-arketimit dhe i kthen aplikantit kopjen e dyte te formularit te porosise se pullave te akcizes.

44.1.4 Per pullat e furnizuara aplikanti do te dorezoje nje vertetim marrje i cili do t’i bashkangjitet kopjes se pare te formularit te porosise se pullave dhe regjistrit te pullave gjendje qe mbahet nga inspektori i kontrollit te pullave te akcizes.

44.1.5 Asnje person nuk mund te bleje pulla akcize sipas menyres se mesiperme me shume se dy here ne vit.

4. Ne piken 50. Rimbursimi i akcizes behen keto ndryshime :

50.6.(b) Te ktheje pullat e akcizes prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve.

50.7 Ne Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve do te verifikohet akciza qe eshte paguar dhe nese te gjitha kushtet per rimbursim jane plotesuar do te konfirmohet rimbursimi i akcizes dhe do t’i kthehet aplikantit kopja e dyte e autorizimit per rimbursim. Verifikimi i dokumentacionit dhe afatet e rimbursimit percaktohen në Udhëzimin nr. 7 datë 16.6.2003 “Për Akcizat”.

5. Ky udhezim hyn ne fuqi me botimin ne Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Malaj